

STATUTI

I Shoqerise me perjegjesi te kufizuar

“OMEGA-AL” sh.p.k

Personi qe firmos me poshte:

- Armand Dosti, me nr ID I30218142R lindur me 18.02.1983, ne Tirane,Albania
dhe banues ne Tirane.

Ne baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtaret dhe Shoqerite Tregëtare ",
krijojne Statutin e ketij subjekti, perkatesisht Shoqerise.

KREU 1

Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.

- (1) Sot me date 14/01/2021, une themeluesi Armand Dosti, kam vendosur, te krijoj nje shoqeri me përgjegjësi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtaret dhe Shoqerite Tregëtare ", dhe aktet e tjera nenligjore qe jane ne fuqi. Shoqeria eshte nje person juridik Shqipetar, i cili do te ushtroje aktivitetin privat ne Territorin e Republikes se Shqiperise, pas regjistrimit ne QKB.
- (2) Themelues i Shoqerise eshte;
Armand Dosti, me ID I30218142R, atesia Parim. I datelindjes 18.02.1983 dhe banues ne Rrugen "Laert Vathi, Pallati 60/1.Ap 23" Laprake, Tirane

Neni 2


Emertimi

Emri i Shoqerise eshte "OMEGA-AL" sh.p.k

Neni 3

Objekti

Ushtrimi i akvitetit Import eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem me shumice dhe pakice si: Pajisje te ndryshme te fonise, zerit. Riparim, montim, tregtim te pajisjeve dhe sistemeve audio dhe ndricimit profesional. Vegla muzikore si dhe riparimi i tyre. Dhenia me qera e perdorimit te pajisjeve te ndryshme audio dhe te ndricimit profesional. Organizimi i koncerteve dhe spektaklev te ndryshme me keto pajisje. Tregtim artikuj te ndryshem industriale. Projekte dhe instalime te sistemeve te fonise, zerit, ndricimit professional, video, ledwall/ekran led, projektor, kamera, stage, skene, podium, sisteme perkthimi, sistem



konference, import, eksport dhe sherbime te ndryshme te lidhura me sistemet audiovisuale. Organizim dhe menaxhim eventesh te ndryshme, konsulence dhe menaxhim projekti, kontraktim pajisjesh te ndryshme per realizimin e aktiviteve dhe eventeve. Ofrim sherbimi efekte speciale, kontraktim pajisjesh piroteknike brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise, do te jete e pakufizuar. Ajo mund te Shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se Ortakeve

Neni 5
Selia

(1). Selia e Shoqerise ndodhet ne adresë Rruga "Rexhep Shala, Nd nr 3, Njesia Administrative nr 14, Yzberisht Tirane "

(2) Adresa e fakes zyrtare te Internetit (nese ka) eshte: Omega-al.com

(3) Adresa e Shoqerise, per qellime komunikimi elektronik (nese ka) eshte si vijon Armand.dosti@omega-al.com

Neni 6
Shoqeria ka Vulen e Saj ku jane te percaktuara inicialet e emertimit te saj, NIPTI dhe adresa baze.

KREU II
Kapitali

Neni 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestari, njekohesishet dhe Kapital Themeltar i Shoqerise eshte; 100 000 (njeqind mijë) leke, perkatesisht ne nje kuote me vlore 100 000 leke


Kapitali Themeltar perbehet nga Kontribute ne vlore monetare shuma 100 000 leke.

Neni 8

Pjesemarja e Themeluesve ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise eshte ne përputhje me kontributet e meposhtme;

- Ortaku Armand Dosti, zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 100 000 leke, qe perben 100 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

Neni 9
Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.



Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesave te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe kontributet ne natyre, gje e cila arrihet nepermjet emerimit ne rruge ligjore te nje eksperti te autorizuar, per keto kontribute sipas kerkeses se paraqitur nga nje person I autorizuar nga te gjithe ortaket.

Ne asnjë rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi I Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Orakeve, e cila merr vendime ne te nejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesave të kapitalit që përfaqesojne.

Neni 10 **Transferimi I Kapitalit**

Kuotat e Kapitalit ne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, si dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit ne kapitalin e Shoqerise
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar, jane lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie.

KREU III **Organet vendimarrese dhe drejtuese**

Neni 11 **Organet Vendimarrese**

Asambleja e Orakeve, është organi I vetem vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Orakeve, është organi I vetem vendimarres i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim te Statutit, sipas modalitetave te pëcatuara me ligj.

Asambleja e pergjithshme e orakeve është pergjegjese për marrjen e vendimeve për Shoqërine per çeshtjet e me poshtme;

- Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdusve dhe Eksperteve Kontabel te Autorizuar.
- Përcaktimin e shperblimeve per Administratoret, Likujdusit dhe Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve per ecurine e veprimtarise.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e Shoqerise ne Gjykata te te gjitha niveleve si dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjetër, apo nje person i tretë.

Administratori I Shoqerise (ne rastin kur nuk eshte Ortak), nuk mund te veproje si perfaquesues I ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi I perfaqsimit mund te jepet vetem per nje mbledhje asambleje te pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose, nese parashikohet nga Statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permbole; vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij nenit, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, për te marre vendime pavarsisht parregullsise.

Neni 13

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme. Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjesë ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 (tridhjete) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumin te permendor me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejtin rend dite.

Neni 14 Marrja e vendimeve

Asambleja e per gjitheshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e per gjitheshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres, per ceshjtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- c) Emerimin e shkarkimin e likujdusve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
- d) Percaktimin e shperblimeve,
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
Cdo ndryshim statute duhet t e depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesit, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 16 Administrimi

- (1) Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riparteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- (3) Personi i me poshtem caktohet si Administratore i shoqerise

Te dhenat e identifikimit:
(mbiemrat, emrat, adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimit:

____ Armand Dosti _____ me ID I30218142R



Atesia; ...Parim.....

Datelindja: 18.02.1983, me adresë banimi Rruga "Laert Vathi, Pallati 60/1.Ap 23"
Laprake, Tirane

Neni 17

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqerise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregetare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- d) Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregtare.
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlore me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlore me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne Fuqi.

Neni 18

Pergjegjesia e e administratorit

Administratori eshte perjegjes individualisht, ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe I sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e pernjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet:
 - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesi.
 - b. Te ushtroje kompetencat qe I njohen me ligj dhe me Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
 - c. Të vleresoje me perjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
 - d. Te parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqërise.
 - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'I demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Në mënyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'I demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundershtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtaret dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
 - U kthen ortakeve kontributet
 - U paguan ortakeve interesa apo dividente
 - U shperndan aktivet e Shoqerise
 - Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
 - Jep kredi.Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit,ortaket individualisht ose se bashku,kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te njekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te dermit qe I eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar,nese eshte e nevojshme.Asnje vendim I asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkeset padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV **Viti finanziar – ekspertet**

Neni 19 **Viti finanziar**

Viti finanziar I shoqerise fillon me date 1 janar dhe perfundon me date 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 20 **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe ate per kotrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 21 **Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujdusit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaketr nuk marrin nje vendim per emerimin e likujdusve,brenda 20 diteve pas prishjes,cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

Neni 22**Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 23**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statutdhe dispozitat e legjisacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipetare.

**O R T A K E T
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

ORTAKU

Armand DOSTI

